



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government
Zyra e Kryeministrit - Ured Premijera - Office of the Prime Minister
Zyra e Komisionerit për Gjuhët - Kancelarija poverenika za jezike
Office of the Language Commissioner

**Thirrje publike për shprehje të interesit për të qenë pjesë e komisioneve vlerësuese
për vlerësimin e Projekt propozimeve të OJQ-ve**

Nr.prot: 65/2022

Data: 24.10.2022

Bazuar në Rregulloren MF- Nr- 04/2017 mbi kriteret, standardet dhe procedurat e financimit publik të OJQ-ve, **për mbështetje financiare për projekte/programe të OJQ-ve, me qëllim të promovimit dhe mbrojtjen e të drejtave gjuhësore, Zyra e Komisionerit për gjuhët**, fton organizatat jo qeveritare dhe shoqërinë civile, të aplikojnë për të marrë pjesë në komisionin e vlerësimit të projekteve, në cilësinë e ekspertëve të jashtëm. Komisioni për përzgjedhjen e ekspertëve, pas intervistimit do të përpilojë listën e të kandidatëve të cilët i plotësojnë kushtet e parapara sipas konkursit. Lista e ekspertëve do të ketë mandat dy (2) vjeçar.

Rregullorja MF- Nr- 04/2017 mbi kriteret, standardet dhe procedurat e financimit publik të OJQ-ve, në Nenin 8, paragrafi 3.2 parasheh që në çdo komision vlerësues, duhet të jenë dy përfaqësues nga grupi i ekspertëve të jashtëm. Për këtë qëllim, ftohen të gjithë kandidatët e interesuar që të aplikojnë për të qenë pjesë e komisionit vlerësues si ekspertë të jashtëm.

Të drejtë aplikimi kanë:

- Të punësuarit në organizatat jo-qeveritare aktive në Republikën e Kosovës;
- Ekspertë të pavarur, të cilët kanë të paktën 5 vite përvojë pune që ndërlidhet me administratën publike, hartimin dhe menaxhimin e projekteve apo fusha të ngjashme.

Kandidatët duhet të plotësojnë këto kushte:

- Duhet të kenë të kryer së paku nivelin e studimeve Bachelor;
- Të kenë të paktën 5 vite përvojë pune;
- Të kenë përvojë në projektet e OJQ-ve;

- Të mos jenë të emëruar politikë, shërbyes civil apo pozita të ngjashme në administratën shtetërore.

Kandidatët duhet të dorëzojnë këto dokumente:

- Një letër motivimi
- Një CV të përditësuar;
- Dëshmi për shkollimin dhe përvojën e punës;
- Të punësuarit në OJQ duhet të dorëzojnë një letër nominimi nga Udhëheqësi i OJQ-së në të cilën aplikuesi është i punësuar.

Aplikimi mund të bëhet përmes e-mailit: zkgj.kpj@gmail.com dhe safete.graicevci@rks-gov.net deri më: 30.10.2022.